

SHQIP sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 18

SHQIP shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	553,494	4,510,742
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	16,802,269	19,212,116
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	-	1,400,000
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	639,081	639,081
Inventarë	8	-	979,510
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	403,064	845,520
Total aktive afatshkurtra		18,397,908	27,586,969
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	10	2,539,584	4,162,070
Total aktive afatgjatë		2,539,584	4,162,070
Total aktive		20,937,492	31,749,039
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	-	114,600
Llogari të pagueshme tregtare	12	31,072,966	45,002,832
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	13	15,303,240	14,517,705
Detyrime tatimore	15	137,564	418,344
Të ardhura të shtyra	16	-	16,568
Të tjera detyrime	17	806,219	-
Total detyrime afatshkurtra		47,319,989	60,070,049
Detyrime afatgjatë			
Total detyrime afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve		47,319,989	60,070,049
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	18	100,000	100,000
Rezerva ligjore		20,000	20,000
Fitime/Humbje të mbartura		(28,441,008)	(21,311,002)
Fitimi/Humbje të ushtrimit	27	1,938,511	(7,130,008)
Total i kapitalit		(26,382,497)	(28,321,010)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		20,937,492	31,749,039

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënime shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHQIP shpk

*(Vlerat janë në Lek)*Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	23,853,915	50,527,485
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	80,676	199,417
Lenda e parë, materiale dhe shpenzime		(19,316,288)	(41,015,158)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime	20	(9,955,240)	(18,177,273)
2) Të tjera shpenzime	21	(9,361,048)	(22,837,885)
Shpenzime të personelit	22	(12,191,893)	(19,281,807)
1) Paga dhe shpërblime		(10,509,496)	(16,601,626)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(1,682,397)	(2,680,181)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23	(883,787)	(1,467,002)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(1,368)	(700)
Të ardhura të tjera	25	10,400,050	3,933,787
Interesa të arkëtueshme dhe të ardhura të tjera të ngjashme		10,400,050	3,933,787
Shpenzime financiare	26	(2,794)	(26,030)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(1,655)	(29,705)
2) Shpenzime të tjera financiare		(1,139)	3,675
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		1,938,511	(7,130,008)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin			
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi/humbja e vitit	27	1,938,511	(7,130,008)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		1,938,511	(7,130,008)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SHQIP shpk


(Merat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitime të Pashpërndara	Fitim/Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2015	100,000	10,000	(21,423,513)	122,511	(21,191,002)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit		10,000	112,511	122,511	(7,130,008)
Transferime në fitim/humbje të mbartura				(122,511)	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	100,000	20,000	(21,311,002)	(7,130,008)	(28,321,010)
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				1,938,511	1,938,511
Fitimi / Humbja e vitit			(7,130,008)	7,130,008	-
Transferime në fitim/humbje të mbartura				1,938,511	(26,382,497)
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	100,000	20,000	(28,441,008)	1,938,511	(26,382,497)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënime të shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shqipërisë për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i SHQIP sh.p.k më 20/02/2017 dhe janë firmosur si më poshtë:


Besnik Myftari
Administrator



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	1,938,511	(7,130,008)
Rregullimet për shpenzimet jamonetare:		
Diferenca konvertimi jo nga aktivitet operative	79,537	203,092
Fitim nga shitja e AAM-ve	128,821	1,047,864
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	883,787	1,467,002
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	4,252,303	3,781,275
Rënie/(rritje) në inventarë	979,510	21,858
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(13,441,680)	3,799,907
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	806,221	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(4,372,991)	3,190,990
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	-	(14,000)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	530,000	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	530,000	(14,000)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e huave	(114,600)	(450,609)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(114,600)	(450,609)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(3,957,591)	2,726,381
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	4,510,742	1,782,505
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	343	1,856
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	553,494	4,510,742

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Gazeta Shqip sh.p.k me Nipt K61528011E është krijuar me vendim Gjykatë të rrethit Tiranë nr. 35118 datë 02.03.2006.

Aktiviteti kryesor i saj është : Botimi, prodhimi, dhe shpërndarja e gazetave, revistave, librave dhe materialeve të tjera të lejuara me ligj.

Kapitali themeltar është: 100.000 lekë.

Ortak i vetëm i shoqërisë është shoqëria "Digit-Alb" Sh.a.

Shoqëria "Gazeta Shqip" sh.p.k është e regjistruar pranë degës së Talim Taksave Tiranë, Adresa e shoqërisë është Rruga 5 Dëshmorët , Ndertese 5- kateshe Nr. 20 Tiranë Numri i punonjesve ne 31 dhjetor 2016 është 13.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të citat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2015 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
Euro/LEK	135.23	137,28
USD/ LEK	128.17	125.79

3.2 Instrumentat financiarë***Mjetet monetare***

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parësë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimërret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së pondëruar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendje të mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Kategoria e Aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%
Te tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjehershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normal e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normal tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdo rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.9. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalje parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mjete monetare në bankë	547,155	847,416
Banka ALL	530,191	806,686
Banka EUR	16,964	40,730
Mjete monetare në arkë	6,339	3,663,326
Arka ALL	6,339	3,663,326
Arka EUR	-	-
Totali	<u><u>553,494</u></u>	<u><u>4,510,742</u></u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Klientë	16,802,269	19,212,116
Totali	<u><u>16,802,269</u></u>	<u><u>19,212,116</u></u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Digit-alb	-	1,400,000
Totali	<u>-</u>	<u>1,400,000</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Tatim mbi fitimin	639,081	639,081
Totali	<u>639,081</u>	<u>639,081</u>

8. Inventarë

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mallra për rishitje	-	975,510
Totali	<u>-</u>	<u>975,510</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Parapagime për furnitorët	177,978	177,978
Shpenzime të shtyra	225,086	667,542
Totali	<u>403,064</u>	<u>845,520</u>

SHQIP shpk

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive Afatgjata Materiale

	Mobilje dhe orëndi	Kompjutera	Pajisje zyre	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Kosta						
Gjendja më 31 dhjetor 2014	3,913,902	9,678,456	642,233	7,278,234	2,770,788	24,283,613
Shtesa		14,000				14,000
Nxjerrje jashtë përdorimit	(991,040)	(4,976,602)	(602,700)		(2,595,788)	(9,166,130)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,922,862	4,715,854	39,533	7,278,234	175,000	15,131,483
Shtesa						
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-
				(4,044,434)	(85,000)	(4,129,434)
Gjendja më 31 dhjetor 2013	2,922,862	4,715,854	39,533	3,233,800	90,000	11,002,049
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	2,884,125	7,379,148	543,349	4,544,806	2,269,249	17,620,677
Amortizimi i vitit	205,955	594,276	19,776	546,687	100,308	1,467,002
Nxjerrje jashtë përdorimit	(820,725)	(4,557,674)	(629,896)		(2,209,971)	(8,118,266)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,269,355	3,415,750	33,229	5,091,493	159,586	10,969,413
Amortizimi i vitit						
Nxjerrje jashtë përdorimit	130,701	325,027	1,260	423,717	3,083	883,787
	-	-	-	(3,305,735)	(85,000)	(3,390,735)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	2,400,056	3,740,777	34,489	2,209,474	77,669	8,462,465
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2014	1,029,777	2,299,308	98,884	2,733,428	501,539	6,662,936
Gjendja më 31 dhjetor 2015	653,507	1,300,104	6,304	2,186,741	15,414	4,162,070
Gjendja më 31 dhjetor 2016	522,806	975,077	5,044	1,024,326	12,331	2,539,584

SHQIP shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

11. Hua Afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Kredi Union Bank	-	114,600
Totali	<u>-</u>	<u>114,600</u>

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Furnitorë	31,072,966	45,002,832
Totali	<u>31,072,966</u>	<u>45,02,832</u>

13. Llogari të pagueshme tregtare palë të lidhura

Llogaritë e pagueshme tregtare palë të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Furnitorë palë të lidhura	15,303,240	14,517,705
Totali	<u>15,303,240</u>	<u>14,517,705</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Sigurime Shoqërore dhe shëndetsore	120,015	349,614
Tatim mbi të ardhurat personale për punonjës (TAP)	17,550	44,850
Tatim në burim	-	23,880
Totali	<u>137,564</u>	<u>418,344</u>

15. Te ardhura te shtyra

Në këtë zë përfshihen të ardhurat e shtyra të cilat lidhen me abonimet që i perkasin periudhës në vazhdim dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Te ardhura te shtyra	-	16,568
Totali	<u>-</u>	<u>16,568</u>

16. Te tjera detyrime

Në zërin Te tjera detyrime përfshihen pagat e paterhequra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Paga	806,219	-
Totali	<u>806,219</u>	<u>-</u>

17. Kapitali themeltar

Kapitali i nënshkruar

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është në vlerën 100,000 lek.

Rezerva ligjore

Rezerva ligjore e shoqërisë është në vlerën 20,000 lek.

Fitime/Humbje e mbartur

Shuma prej (28,441,008) lekë përfaqëson humbjen e mbartur nga vitet e kaluara.

Humbja e vitit ushtrimor

Shuma prej 1,938,511 lekë përfaqëson fitimin e këtij viti ushtrimor.

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura nga shitja e mallrave	6,754,541	14,582,483
Të ardhura nga reklamimet	16,047,736	30,156,554
Të ardhura të tjera	1,051,638	5,788,448
Totali	<u>23,853,915</u>	<u>50,527,485</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullimi i tatueshëm	24,367,348
Shtohen të ardhurat e rimarrë nga 2015	16,568
Zbriten të ardhurat nga shitja e asetit	(530,000)
Shuma e qarkullimit të korrektuar	23,853,915
Diferenca nga Fitim/Humbjet Valutore-Tregtare	112,158
Zbritet humbja nga shitja e asetit	(31,482)
Sipas Kontabilitetit	<u>23,934,591</u>
Diferenca	<u>-</u>

19. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Humbje nga këmbimet dhe përkthimet valutore	(88,325)	(14,566)
Fitim nga këmbimet valutore	200,483	213,983
F/Humbje nga shitja e asetit	(31,482)	
Totali	80,676	199,417

20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave të shitura e cila detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Kostoja e mallrave të shitur	9,775,240	16,043,067
Shërbim fotografie dhe dizenjimi	180,000	2,134,206
Totali	9,955,240	18,177,273

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Publicitet, rekama	830,000	8,570,000
Komisione dhe honorare	965,796	3,273,125
Shpenzime qeraje	2,560,768	2,605,675
Blerje të ndryshme.kancelari etj	1,137,475	2,230,575
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,000,420	1,484,052
Komisione dhe transporti	184,760	909,977
Karburant	589,200	812,650
Sigurime	828,512	908,469
Abonime	190,727	318,749
Shpenzime të tjera	899,274	547,977
Vl mbetur nga D/J perdorimi AAM	-	1,047,864
Komisione bankare	96,835	98,885
Taksa të ndryshme	77,278	29,887
Totali	9,361,048	22,837,885

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime për paga	10,509,496	16,601,626
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	1,682,397	2,680,181
Totali	<u><u>12,191,893</u></u>	<u><u>19,281,807</u></u>

23. Shpenzime amortizimi

Shpenzimi i amortizimit të aseteve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime amortizimi	883,787	1,467,002
Totali	<u><u>883,787</u></u>	<u><u>1,467,002</u></u>

24. Shpenzime të tjera shfrytezimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penaltitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015;

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Penalite dhe gjoka	1,368	700
Totali	<u><u>1,368</u></u>	<u><u>700</u></u>

25. Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura të tjera	10,400,500	3,933,787
Totali	<u><u>10,400,500</u></u>	<u><u>3,933,787</u></u>

26. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura/(shpenzime) nga këmbimet valutore nga huaja	(1,139)	3,675
Shpenzime për interesa	(1,655)	(29,705)
Totali	(2,794)	(26,030)

27. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Fitimi para tatimit	1,938,511	(7,130,008)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	1,527,727	2,775,738
Shpenzime të tjera	1,527,727	2,775,738
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	3,466,238	(4,354,270)
Humbja fiskale e mbartur	(4,354,270)	-
Tatim fitimi 15%	-	-
Fitim/(Humbja) neto	1,938,511	(7,130,008)

27. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Digitalb	-	-	1,400,000	-
Top Channel		6,956,380		5,174,845
Top Gold		8,346,860		9,342,860
	-	15,303,240	1,400,000	14,517,705

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Digit-alb	14,000,000	500,000	23,100,000	7,316,400
Top Channel	420,000	2,307,348	845,000	2,611,320
Top Gold	-	-	-	270,000
	14,420,000	2,807,348	23,945,000	10,197,720